

PRIVATIZIMI I BANKËS SË KURSIMEVE

---

**Edvin Libohova**

**Drejtore i Përgjithshëm, Banka e Kursimeve**

**Të nderuar miq,**

**Zonja dhe zotërinj,**

Në reformimin e sistemit financiar dhe bankar të vendit, privatizimi i Bankës së Kursimeve përbën pa dyshim procesin më të rëndësishëm dhe më të vështirë njëkohësisht.

Siç dihet, fillesat e këtij procesi datojnë vite më parë kur në strategjinë për reformimin e sistemit bankar është përcaktuar si hallkë kryesore edhe privatizimi i bankave me kapital shtetëror.

Vitin e kaluar përfundoi privatizimi i Bankës Kombëtare Tregtare, proces i cili zgjati për rreth 3 vjet.

Banka e Kursimeve, përpara fillimit të procesit të privatizimit, në vitet 1998-1999 i është nënshtruar një procesi strukturimi të asistuar nga ekspertë të Bankës së Irlandës.

Pas këtij strukturimi, në dhjetor të vitit 1999, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin për formën dhe formulën e privatizimit të Bankës së Kursimeve, i cili përbën edhe ligjin bazë për këtë privatizim.

Sipas këtij ligji, privatizimi i bankës do të realizohet nëpërmjet shitjes deri në 100 për qind të aksioneve , nëpërmjet një kombinimi midis investitorit strategjik ( jo më pak se 35 për qind të aksioneve), institucioneve financiare ndërkombëtare ( jo më shumë se 49 për qind të aksioneve ) dhe biznesit privat vendas ( deri në 24 për qind të aksioneve ).

Procedurat e tenderit ndërkombëtar të privatizimit kanë filluar vitin e kaluar dhe që në fillim të këtij viti , në kuadër të një financimi të Bankës Botërore, ky proces asistohet nga kompania këshilluese MaxwellStamp, Londër.

Në fund të muajit qershor 2001, Ministria e Financave shpalli hapjen e tenderit ndërkombëtar për privatizimin e bankës, ku faza parakualifikuese ( përcaktimi i shortlistës ) duhej të përfundonte brenda muajit shtator 2001.

Situata e pafavorshme në tregun financiar europian ( procese shkrirjeje, thithjeje, privatizimi e bashkimi bankash dhe përgatitjet intensive për futjen e euros) përfshirja e mjaft bankave perëndimore me reputacion në privatizimin e bankave në Europën Lindore, situata e pastabilizuar në rajon ( Maqedonia dhe Kosova ), zgjedhjet parlamentare të tejzgjatura në Shqipëri dhe së fundi ngjarjet tronditëse të 11 shtatorit në Amerikë, të gjitha këto patën ndikimin e tyre në nivelin e pamjaftueshëm të shprehjes së interesit nga ana e investitorëve strategjikë për privatizimin e Bankës së Kursimeve.

Në një situatë të tillë, Ministria e Financave dhe Komisioni i Privatizimit e panë të arsyeshme që procesi të shtyhej, duke përcaktuar si fazë të re parakualifikuese fundin e muajit mars 2002 dhe si kohë për zhvillimin e tenderit, fundin e muajit maj 2002.

Në lidhje me institucionet financiare ndërkombëtare tashmë është bërë e ditur se janë të interesuara për këtë proces EBRD-Londër, IFC-Washington dhe DEG-Keln. Me sa paraqita më sipër, u

mundova të jap një tablo të shkurtër të rrjedhës historike e kronologjike të procesit, informacion ky i domosdoshëm për këtë auditor.

Po ç'përfaqëson sot Banka e Kursimeve, banka më e madhe në Shqipëri, në tregun bankar dhe financiar të vendit ?

Disa nga treguesit kryesorë të saj janë :

shtrirje territoriale në të gjithë vendin, me mbi 100 degë e agjenci;  
rreth 65 për qind të depozitave të qytetarëve;  
rreth 75 për qind të tregut të bonove të thesarit;  
mbi 70 për qind të pagesës së pensioneve;  
mbi 90 për qind të vëllimit të pagesave për llogari të buxhetit të shtetit

Totali i aseteve rreth 170 miliardë lekë.

Duke patur parasysh madhësinë e bankës dhe vështirësinë që ajo paraqet për t'u administruar dhe më pas privatizuar si e tillë, procesi i ristrukturimit të saj ka qenë i pandërprerë, duke u shtrirë në aspekte të tilla si:

- rritja e efikasitetit të degëve dhe të agjencive;
- ulja e numrit të punonjësve;
- zgjerimi i sistemit të informatizuar;
- kalimi i një pjese të pagimit të pensioneve tek Albapost;
- kalimi i kredive të këqija tek ATK-ja;
- regjistrimi i pronave;
- rivlerësimi i aktiveve të paluajtëshme etj.

Veprimtaria e bankës i është nënshtruar auditimit të bërë nga KPMG-ja për periudhën deri më 30 qershor 2001. Pavarësisht nga faza tranzitore e privatizimit, stafi menaxhues i bankës është munduar të ruajë dhe të përmirësojë shërbimin ndaj klientelës, besimin që ajo ka patur dhe ka tek banka, duke investuar në motivimin e personelit, në infrastrukturën e bankës etj..

Shprehje e qartë e kësaj situate është treguesi i rritjes së vëllimit të depozitave (pavarësisht se interesi i ofruar prej nesh është nga më të ulët në treg), si më poshtë :

Depozita të qytetarëve në lekë	31.12.00	30.09.01	31.10.01
Në miliardë lekë	122,2	129,3	131,1
Depozita të qytetarëve në valutë			
Konvertuar në miliardë lekë	18,2	19,5	19,8

Aktualisht, po punohet intensivisht për përballimin e fluksit që do të sjellë futja në qarkullim e euros, proces ky që po shoqërohet me rritjen e mëtejshme të vëllimit të depozitave të qytetarëve.

Gjatë vitit 2002, deri në privatizim, banka do të vazhdojë procesin e reformave strukturore, duke rritur efektivitetin e degëve, duke ulur numrin e punonjësve, duke transferuar zyra të tjera të pagimit të pensioneve tek Albapost, duke zgjeruar numrin e degëve të kompjuterizuara etj.. Nga ana e saj, Ministria e Financave po përgatit tenderin për kalimin e shërbimit të buxhetit në 5 qytete të mëdha nga Banka e Kursimeve tek bankat private ( proces ky i nisur në muajin gusht të këtij viti nëpërmjet një projekti pilot në Elbasan ).

**Të nderuar kolegë,**

Sfida që kemi përpara është e vështirë dhe ajo duhet përballuar me qetësi, me profesionalizëm, me impenjim maksimal dhe me përkushtim të të gjithëve, pasi vetëm kështu ne do të mundim të realizojmë një privatizim të suksesshëm, i cili më pas do të japë impaktet e tij të padiskutueshme në zhvillimin ekonomik dhe financiar të vendit.

Ju faleminderit !